



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**U R D H Ë R**

**Nr.11, datë 02.11.2010**

**Për**

**“Lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit midis Albanian Mobile Communications sh.a dhe Altelecom sh.a”**

Në mbështetje të nenit 60 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullore Nr.18, date 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, Rregullore Nr.19, datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar, VKD nr.1435, datë 02.11.2010 për *“Mbylljen e procedimit administrative të filluar me Vendimin nr.1353, datë 06.08.2010 për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi përfundimin e afatit të vlefshmërisë dhe rinovimin e marrëveshjes së interkoneksionit midis Altelecom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a”*

**U R D H E R O J:**

1. Albanian Mobile Communications sh.a (AMC) dhe Altelecom sh.a të lidhin marrëveshje Interkoneksioni menjëherë me marrjen e njoftimit të këtij Urdhëri;
2. Marrëveshjes së Interkoneksionit të përmbajë përcaktimet e RIO-ve të miratuara nga AKEP;
3. Palët të depozitojnë në AKEP një kopje të Marrëveshjes së Interkoneksionit të nënshkruar nga palët brenda 3 (tre) ditëve nga data e nënshkrimit të saj;
4. Moszbatimi i këtij urdhëri përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas parashikimeve të nenit 137 të ligjit nr. 9918 date 19.05.2008.
5. Ky Urdhër hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

**A N Ë T A R Ë T:**

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURÇE**